

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: KOMUNA E MAMUSHËS

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	626-26-4747-1-2-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Sentimed SHPK
NUI	81149978
	1
Adresa	Rr.Ali Vitija, Kompleksi Model Sllovenia A1/2
Vendi	Prishtine
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	049214668
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Defrim Sahitaj
Adresa elektronike	support@sentimed-ks.com
Data e parashtrimit të kërkesës	31.07.2026

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-i
Adresa elektronike t

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

KOMUNA E MAMUSHËS

Aktiviteti i Prokurimit: 626-26-4747-1-2-1

Titulli i tenderit: "Furnizimi me pajisje specifike mjekësore Laboratorike për QKMF-n në Komunën e Mamushës"

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 i LPP

Neni 68 i LPP

Neni 69 i LPP

Neni 25 i RRPP

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Pretendimi ankimor nr. 1 – Lidhur me eliminimin e ofertës për mosdorëzimin e planit dinamik të liferimit

Ne, si Operator Ekonomik ofertues, konsiderojmë se arsyetimi i Autoritetit Kontraktues për eliminimin e ofertës sonë për shkak të mosdorëzimit të planit dinamik të liferimit nuk përbën bazë të qëndrueshme dhe të arsyeshme për refuzimin e ofertës sonë.

Në Dosjen e Tenderit është përcaktuar qartë se: **“Kontrata do të fillojë të ekzekutohet menjëherë pas nënshkrimit të saj dhe do të përfundojë pas furnizimit dhe montimit të pajisjeve të kërkuara sipas afatit të liferimit, i cili nuk duhet të jetë më i gjatë se 30 ditë.”**

Pra, vetë Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar afatin maksimal të realizimit të kontratës prej 30 ditësh. Me dorëzimin e ofertës sonë, ne kemi pranuar të gjitha kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, përfshirë edhe afatin maksimal të ekzekutimit të kontratës.

Më pas, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar:

- dorëzimin e një plani dinamik (afatit të liferimit);
- që ky plan të mos jetë më i gjatë se 30 ditë;
- si dhe ka përcaktuar se mosdorëzimi i këtij dokumenti do të rezultojë me eliminimin e Operatorit Ekonomik.

Ne konsiderojmë se një kërkesë e tillë, në rrethanat konkrete të kësaj procedure, nuk paraqet një kërkesë që ndikon në mënyrë substanciale në vlerësimin e ofertës sonë.

Kjo për faktin se:

- **Afati maksimal i realizimit të kontratës prej 30 ditësh është përcaktuar paraprakisht nga vetë Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit, ku është specifikuar qartë afati maksimal i liferimit dhe montimit të pajisjeve;**
- **Operatori Ekonomik, me dorëzimin e ofertës, ka pranuar të gjitha kushtet e tenderit, përfshirë edhe detyrimin për realizimin e kontratës brenda afatit prej 30 ditësh;**
- **Një dokument shtesë që vetëm përsërit afatin e realizimit të përcaktuar tashmë nga Autoriteti Kontraktues nuk i shton vlerë reale procesit të vlerësimit të ofertës, pasi nuk ndryshon as afatin e ekzekutimit, as çmimin, as**

specifikimet teknike dhe as aftësinë e Operatorit Ekonomik për realizimin e kontratës.

Nëse qëllimi i Autoritetit Kontraktues ka qenë të sigurojë një plan të detajuar të realizimit të kontratës, atëherë një kërkesë e tillë do të duhej të përcaktohej në mënyrë të qartë, duke specifikuar elementet që duhet të përmbajë plani dinamik, si fazat e furnizimit, montimit, testimit dhe pranimit të pajisjeve.

Megjithatë, në rastin konkret, kërkesa për plan dinamik rezulton të jetë vetëm një përsëritje e një afati të përcaktuar paraprakisht në Dosjen e Tenderit. Një dokument i tillë nuk ka ndonjë ndikim në përmbajtjen e ofertës sonë dhe nuk paraqet ndonjë ndryshim apo rrezik për realizimin e kontratës, pasi afati maksimal prej 30 ditësh është pranuar nga ne me dorëzimin e ofertës.

Për më tepër, eliminimi i ofertës sonë vetëm për mungesën e këtij dokumenti konsiderojmë se është një masë joproporcionale dhe tepër formale, pasi bëhet fjalë për një mungesë që nuk ndikon në aftësinë tonë për përmbushjen e kontratës dhe nuk cenon interesin e Autoritetit Kontraktues.

Andaj, kërkojmë nga Autoriteti Shqyrtues i Prokurimit që këtë pretendim ta aprovojë dhe të konstatojë se eliminimi i ofertës sonë mbi këtë bazë ka qenë i paarsyeshëm dhe jo në përputhje me parimet e proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së drejtë në procedurat e prokurimit publik.

Pretendimi ankimor nr. 2 – Lidhur me vlerësimin e gabuar të përmbushjes së kërkesës për projektet e ngjashme

Ne, si Operator Ekonomik ofertues, kundërshtojmë arsyetimin e Autoritetit Kontraktues për refuzimin e ofertës sonë lidhur me pretendimin se nuk kemi përmbushur kërkesën për realizimin e projekteve të ngjashme në vlerën minimale prej 42,000.00 euro.

Autoriteti Kontraktues në arsyetimin e eliminimit ka theksuar se kontrata e paraqitur në listën e projekteve me pozicionin nr. 2 është kontratë e nënshkruar më datë 08.01.2024 dhe se ajo është ende në vazhdim deri më 22.02.2030, duke konstatuar se deri në momentin e vlerësimit janë realizuar blerje në vlerë prej 37,346.88 euro dhe se kjo vlerë nuk e përmbush kërkesën minimale të përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Megjithatë, ne konsiderojmë se ky vlerësim i Autoritetit Kontraktues është i pasaktë dhe nuk reflekton realitetin e realizimit të projekteve të ngjashme, pasi ne kemi dorëzuar dëshmi konkrete që vërtetojnë se kemi realizuar projekte të ngjashme në vlerën e kërkuar prej së paku 42,000.00 euro, madje e kemi tejkalur këtë vlerë.

Në kuadër të ofertës sonë, ne kemi paraqitur listën e projekteve të ngjashme dhe si dëshmi kemi bashkëngjitur faturat përkatëse, të cilat dëshmojnë realizimin faktik të furnizimeve dhe punëve të kryera. Faturat paraqesin dokumentin më të drejtpërdrejtë dhe më të

besueshëm për të dëshmuar vlerën reale të realizuar, pasi ato konfirmojnë se shërbimi/furnizimi është kryer dhe se është realizuar qarkullimi përkatës.

Fakti që një kontratë është ende në vazhdim nuk nënkupton automatikisht se vetëm vlera totale e kontratës duhet të merret si bazë për vlerësimin e përvojës së realizuar. Përkundrazi, për qëllim të dëshmimit të përvojës së ngjashme, duhet të merret parasysh pjesa e kontratës e realizuar dhe e dëshmuar me dokumentacion përkatës, në këtë rast përmes faturave të dorëzuara nga ana jonë.

Një praktikë e tillë është e njohur edhe në procedurat e prokurimit publik, ku për vlerësimin e përvojës së ngjashme merret për bazë realizimi faktik i kontratës dhe jo vetëm kohëzgjatja formale e kontratës. Faturat shërbejnë si dëshmi objektive për punën/furnizimin e realizuar dhe për vlerën reale të përmbushur.

Gjithashtu, ekzistojnë edhe interpretime dhe vendime të Organit Shqyrtues të Prokurimit, ku është pranuar se përvoja e ngjashme mund të dëshmohet përmes dokumenteve që vërtetojnë realizimin faktik të kontratës, përfshirë faturat, pagesat dhe dokumente të tjera relevante.

Për këtë arsye, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues nuk ka bërë një vlerësim të plotë të dokumentacionit të dorëzuar nga ana jonë dhe ka anashkaluar provat konkrete që dëshmojnë përmbushjen e kriterit të kërkuar.

Andaj, kërkojmë nga Autoriteti Shqyrtues i Prokurimit që këtë pretendim ta aprovojë dhe të konstatojë se kemi përmbushur kërkesën për realizimin e projekteve të ngjashme në vlerën minimale të kërkuar, ndërsa eliminimi i ofertës sonë mbi këtë bazë ka qenë i pabazuar.

Duke u bazuar në të gjitha argumentet dhe provat e paraqitura më lart, kërkojmë që **kërkesa jonë për rishqyrtim të aprovohet**, ndërsa vendimi për eliminimin e ofertës sonë të anulohet si i pabazuar.

Po ashtu, kërkojmë që lënda të kthehet në **rivlerësim**, ku oferta jonë të trajtohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe pas rivlerësimit të shpallemi **fitues të kësaj procedure**, pasi kemi ofertën me çmimin më të ulët ekonomik, me një diferencë prej mbi **6,000.00 euro** krahasuar me ofertën e rekomanduar për kontratë.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*